



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 24
Prishtinë, më 21 korrik 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 21 KORRIK 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kryetari njoftoi Kuvendin me vendim e presidentes të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetes së ndjerë, Nekibe Kelmendi, me deputeten e re, nga subjekti politik i LDK-së znj. Kimete Bytyçi, të cilës i dëshiroi punë të mbarë.
Kryetari ftoi deputeten Kimete Bytyçi që të nënshkruajë deklaratën e betimit.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet,

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtje nga zjarri,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-10 për noterinë
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rregullimin e tokës,
17. Shqyrtimi i raportit të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010,
18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe ligjit nr. 03/L-157 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin,
19. Njoftimi i Partisë së Pavarur Liberale lidhur me vendimin për zëvendësimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të SLS dhe kryetarit të Komisionit për Kthim dhe Komunitete.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Duda Balje, Rexhep Selimi, Ardian Gjini, Flora Brovina, Lutfi Haziri, Myzejene Selmani, Liburn Aliu, Ramiz Lladrovci, Burim Ramadani, Rita Hajzeraj-Beqaj, Visar Ymeri, Shaip Muja dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja, Alma Lama, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, në lidhje me ratifikimin e marrëveshjeve të arritura në bisedime me Serbinë, sipas Rezolutës së Kuvendit nr. 04-R-001, të datës 10 mars 2011.

Kryeministrit Thaçi, iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja, Donika Kadaj-Bujupi, parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me projektin energjetik për ndërtimin e termocentraleve të reja.

Kryeministrit Thaçi, iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Deputetja, Salihe Mustafa e lexoi pyetjen për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiç, në lidhje me planet e Ministrisë që ai drejton për përmirësimin e kushteve në Institutin Special në Shtime.

Ministri Rashiç nuk ishte prezent në mbledhje.

Deputetja, Afërdita Berisha-Shaqiri, parashtoi pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja, në lidhje me kalueshmërinë e testit të maturës në gjimnaze dhe në shkolla profesionale, në Kosovë.

Ministri Buja , iu përgjigj pyetjes së deputetes Afërdita Berisha-Shaqiri.

Deputetja, Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Ferid Agani, në lidhje me monitorimin e institucioneve shëndetësore publike e private prej një numri të vogël të inspektorëve shëndetësorë.

Ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputeti, Niazi Idrizi, parashtoi pyetje për ministrin e Financave, Bedri Hamza, në lidhje me shkallën e grumbullimit të të hyrave nga ana e ATK-së.

Ministri Bedri Hamza, iu përgjigj pyetjes së deputetit Idrizi.

Deputetja, Donika Kadaj-Bujupi, parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me veprimet konkrete të Qeverisë për luftimin e krimit të organizuar.

Kryeministrit Thaçi, nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti, Niazi Idrizi, parashtoi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, në lidhje me amendamentimin e Ligjit për shtetësinë.

Ministri Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Idrizi.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 8 e 14 korrik 2011

Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të datës 8 e 14 korrik 2011.

Deputeti Hydajet Hyseni, pati vërejtje në transkriptin e datës 14 korrik 2011, në pjesën e fjalës së tij, lidhur me konkluzionet e dakorduara për regjistrin civil.

Kryetari konstatoi se kjo pjesë e fjalës së deputetit Hysen duhet të korrigjohet në transkriptin e lartëshënuar.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe amendamentin nr. 22.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, dhe amendamentin nr. 3.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social

Kryesuesi, **Xhavit Haliti**, i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Këshillin Ekonomiko-Social.

Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e arsyetoi anëtarja e këtij komisioni, deputetja, Flora Brovina.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e znj. Brovina, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, dhe amendamentin nr. 21.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtje nga zjarri

Kryesuesi, i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për mbrojtje nga zjarri.

Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi anëtari i këtij komisioni, deputeti, Fatmir Xhelili.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Xhelili, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, dhe amendamentin nr. 9.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për mbrojtjen nga zjarri.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-10 për Noterinë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-10 për noterinë.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentin e vetëm të propozuar.

Kuvendi miratoi amendamentin nr.1.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentin e miratuar, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 74,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për nr. 03/L-10 për Noterinë.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, **Besim Beqaj** tha se projektligji të cilin po e shqyrtojmë sot, është rezultat i punës në vazhden e kompletimit të infrastrukturës ligjore, të Ministrisë që ai drejton.

Në vazhdim, ministri theksoi se me nxjerrjen e këtij ligji do të arriheshin disa qëllime, siç janë: përmirësimi i kornizës ligjore për çështjet që kanë të bëjnë me kërkesat, lëndët, rastet, çështjet dhe procedurat që dalin nga fushëveprimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 ose cilitdo akt pasardhës ligjor.

Më tutje, ministri Beqaj konstatoi se Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nuk e cenon legjislacionin e BE-së.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti, Zenun Pajaziti, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha- Shala, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+ “, Fikrim Damka, si dhe deputeti, Haki Demolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 52,

Kundër----- 8,

Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, **Besim Beqaj**, tha se me përfshirjen e këtij ligji në sistemin juridik të vendit, do të arrihen disa qëllime, ndër më të rëndësishmet prej tyre janë: përmirësimi i kornizës ligjore për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe përcaktimi i qartë i kompetencave të saj.

Në vazhdim, ministri theksoi se aktualisht juridiksioni dhe rregullat mbi organizimin dhe veprimtarinë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha- Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar” Vetëvendosje”, Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Muhamet Mustafa, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, si dhe deputetët: Bekim Haxhiu, Sala Berisha- Shala, Teuta Sahatqija, Visar Ymeri, Zenun Pajaziti dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,
Kundër-----18,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, **Besim Beqaj**, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i rregullativës ligjore për përcaktimin e procedurave për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të caktuara, pasurisë dhe obligimeve të tyre nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit apo paraardhëses të saj, Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Në vazhdim, ministri theksoi se pas miratimit të këtij ligji do të mundësohej rehabilitimi i ndërmarrjeve të caktuara dhe rikthimi i qëndrueshmërisë së tyre si ndërmarrje afariste për t'i sjellë përfitime ekonomisë së Kosovës.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha- Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar "6+" Rasim Demiri, si dhe deputetët: Sadri Ferati, Justina Shiroka-Pula, Sali Morina dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,

Kundër-----11,

Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë, **Ramë Buja**, tha se me këtë projektligj parashihet përcaktimi i parimeve themelore dhe krijimi i bazës ligjore për organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të Kosovës.

Në vazhdim, ministri u fokusua në çështjet që adreson projektligji, disa nga të cilat janë: ofrimi i statistikave zyrtare për shtetin, administratën dhe publikun e gjerë, përbërjen dhe emërimin e Këshillit statistikor, përmbushja e standardeve ndërkombëtare, si kusht për integrimin në institucionet ndërkombëtare etj.

Më tutje, ai foli për strukturën e projektligjit, duke elaboruar veç e veç përmbajtjen e kapitujve.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Amir Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Arsim Bajrami, dhe Alma Lama, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 48,
Kundër-----10,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **Ramë Buja**, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë.

Në vazhdim, ministri u fokusua në parimet në të cilat bazohet ofrimi i arsimit të lartë, disa nga të cilat janë: liria akademike, barazia para ligjit për të gjithë bartësit e arsimit të lartë, mundësitë e barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë, shumëllojshmëria dhe cilësia e programeve të studimit, fokusimi evropian dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit të lartë, etj.

Më tutje, ai u fokusua në objektivat e arsimit të lartë, duke përmendur disa nga to, si: krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore, përgatitja e studentëve për studime të mëtejshme, praktika profesionale dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, ofrimi i mundësive për të gjithë banorët e Kosovës, korniza evropiane e kualifikimeve etj.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Vataj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Demolli, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu,

në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Myfera Shinik, si dhe deputetët: Emilija Rexhepi, Arsim Bajrami, Armend Zemaj, Xhevahire Izmaku, Aurora Bakalli dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Më pas fjalën e mori, deputeti, **Ismet Beqiri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, i cili propozoi që shqyrtimi i pikave të mbetura të rendit të ditës, të vazhdohet me dt. 22 korrik 2011.

Lidhur me propozimin e z. Ismet Beqiri, kryesuesi kërkoi prononcimin e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Pas prononcimit të tyre, kryesuesi, hodhi në votim propozimin për vazhdimin e mbledhjes plenare më dt. 22 korrik 2011.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin për vazhdimin e mbledhjes plenare më dt. 22 korrik 2011, në orën 10:00.

Kryesuesi e përfundoi mbledhjen e sotme në orën 17:25.

22 korrik 2011, e premte ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare të filluar më 21 korrik 2011

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar me datë 21 korrik 2011. Ai tha se në radhë është pika nr. 14 e rendit të ditës-

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë

Zv.kryeministri, **Hajredin Kuçi**, tha se nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji qëndron në përmbushjen e obligimeve kushtetuese, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, zv.kryeministri theksoi se me këtë projektligj rregullohet pozita e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh faktin se kjo fushë nuk ka qenë e mbuluar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion, deputeti, Arben Gashi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Idriz Vehapi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivković, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Hydajet Hyseni, Shaip Muja, Halit Krasniqi, dhe zv.kryeministri, Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,

Kundër-----13,

Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, **Mimoza Kusari-Lila**, tha se nevoja për hartimin e këtij projektligji rrjedh nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2010, ku është kërkuar që Ligji në fuqi të harmonizohet me direktivat e BE-së nga kjo fushë.

Në vazhdim, tha se ky projektligj parasheh rregullimin e mënyrës së përcaktimit të kërkesave teknike për produkte, procedurat e vlerësimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara si dhe nxjerrjen e rregulloreve nga ana e ministrive kompetente.

Në fund ajo kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Buzhala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hashim Deshishku, në emër të Grupit Parlamentar” Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rregullimin e tokës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për rregullimin e tokës.

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, **Mimoza Kusari-Lila**, tha se Projektligji për rregullimin e tokës është i një rëndësie të madhe, për shkak se ne te ka munguar legjislacioni i përshtatshëm për rregullimin e tokës.

Në vazhdim, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i kornizës ligjore për parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza vullnetare për krijimin e parcelave më të mëdha dhe rregullimin e tokës bujqësore, pyjeve dhe tokës pyjore.

Në fund ajo kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për rregullimin e tokës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Niazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar” Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq,

ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Haki Demolli, Ardian Gjini dhe Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për rregullimin e tokës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

17. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2010

Deputeti **Armend Zemaj**, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, tha se si komision kemi shqyrtuar raportin e punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Deputetja **Safete Hadergjonaj** në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se kemi shqyrtuar raportin në fjalë dhe kemi rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e raportit të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Blerim Shala, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jelena Bontiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, dhe deputetët: Lutfi Haziri, Shaip Muja, Albulena Haxhiu dhe kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 32,
Kundër----- 40,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2010.

18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe ligjit nr. 03/L-157 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin

Deputetja **Time Kadrijaj**, në emër të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, tha se si komision kemi monitoruar zbatimin e ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe ligjit nr. 03/L-157 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin dhe Kuvendit i kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Në vazhdim ajo tha se mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe Ligjit nr. 03/L-157 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin, komisioni për të cilin ajo referon, e kanë bërë në tri nivele, duke përfshirë institucionet qendrore, institucionet lokale dhe lokalet afariste.

Më tutje deputetja Kadrijaj u fokusua në rekomandimet të cilat i ka bërë Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Në fund ajo kërkoi miratimin e këtij raporti bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe Ligjit nr. 03/L-157 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Bahri Thaçi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Aurora Bakalli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Gëzim Kelmandi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, dhe deputetja Salihe Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe ligjit nr. 03/L-157 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin, bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	73,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Miratohet raporti i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe ligjit nr. 03/L-157 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin, bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional.

19. Njoftimi i Partisë së Pavarur Liberale lidhur me vendimin për zëvendësimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të SLS dhe kryetarit të Komisionit për Kthim dhe Komunitete

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar SLS, ka propozuar zëvendësimin e kryetarit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, dhe të kryetarit të Grupi Parlamentar SLS.

Ai kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar SLS.

Kuvendi miratoi propozimin e Grupi Parlamentar SLS.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti Goran Marinković, emërohet kryetar i Komisionit për të Drejta dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në vend të ish-deputetit Sasha Rashiq.
2. Deputeti Sasha Millosavljević, emërohet kryetar i Grupit Parlamentar të SLS-së, në vend të ish-deputetit Sasha Rashiq.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Kuvendit.

Në fund, kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i PDK-së, ka propozuar zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në vend të deputetit Xhavit Haliti, propozohet deputeti Behar Selimi.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti, Behar Selimi, nga Grupi Parlamentar i PDK-së, emërohet anëtar i Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në vend të deputetit Xhavit Haliti.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 12 : 30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale